

VENDIM
Nr.191, datë 10.4.2004

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË BAJRAM CURRIT TË
MJEDISEVE TË DEGËS SË MOBILIZIMIT, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN
E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT
I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e degës së mobilizimit në qytetin e Bajram Currit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’i kalojnë në pronësi bashkisë së Bajram Currit, për t’u përdorur si kopësht dhe çerdhe për fëmijët.
 2. Prona me numër rendor 500, “Dega e mobilizimit” në Bajram Curri, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
 3. Bashkisë së qytetit Bajram Curri i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.
 4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryetari i bashkisë së Bajram Currit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano